



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 08.10.2024

Nr. 185

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË MALËSI E MADHE , ME  
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E “PARTISË ALEANCA DEMOKRISTIANE  
E SHQIPËRISË”, Z. ARDIAN VUKSAN DEMAJ**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 2087 prot., datë 12.8.2024, Këshilli i bashkisë Malësi e Madhe, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga Këshilltari, zj. Lulë Prelë Botinaj, propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”.

Në mbështetje të nenit 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e “Partisë Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”, për Këshillin e bashkisë Malësi e Madhe, të cilit i kalon mandati i Këshilltarit, është kandidati me numër rendor 2, z. Ardian Vuksan Demaj.

Me shkresën nr. 2584, prot., datë 4.9.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Malësi e Madhe z. Ardian Vuksan Demaj, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet

Data: 08.10.2024 Nr: 185  
Ora: 12:00



“Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Malësi e Madhe, me kandidatin nga lista shumemërore e “Partisë Aleanca Demokristiane e Shqipërisë” z.Ardian Vuksan Demaj”

pararendëse, për Këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e Këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për Këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore, të subjektit “Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër SHK-ADK-19421\_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i Këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të z. Ardian Vuksan Demaj, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, me shkresën nr. 2653 prot., datë 11.9.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile, dhe me shkresën nr. 2652 prot., datë 11.9.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, për z. Ardian Vuksan Demaj.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 10045/1 prot., datë 19.9.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar z. Ardian Vuksan Demaj, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 14375/1 prot., datë 20.9.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Ardian Vuksan Demaj, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar z. Ardian Vuksan Demaj, në Këshillin e Bashkisë Malësi e Madhe, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e Këshilltarit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

## V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Malësi e Madhe, me kandidatin nga lista shumemërore e “Partisë Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”, z. Ardian Vuksan Demaj.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Iirjan CELIBASHI**